



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA POLIÇAN

QËNDRA POLIVALENTE PËR SHËRBIME TË PËRKUJDESIT SHOQËROR

POLIÇAN

NJËSIA E PROKURIMIT

Poliçan ,më ____ . ____ .2025

PROCESVERBAL

Tipi i kontratës - Mall

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM PËR PROCEDURËN E PROKURIMIT “E HAPUR, E THJESHTUAR – MALLRA”

OBJEKTI I PROCEDURËS: "Blerje ushqime për vitin 2025 Per Qëndrën Polivalente Për Shërbime Të Përkujdesit Shoqëror Poliçan"

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):)

- Produkte shtazore 03142000-8
 - Perime me fruta 03221200-8
 - Produkte shtazore, mish dhe produkte të mishit 15100000-9
 - Lëngje frutash 15321000-4
 - Vaj ulliri 15411110-6
 - Vaj gatimi 15411200-4
 - Qumështi i sterilizuar 15511200-5
 - Kos dhe produkte të tjera të fermentuara të qumështit 15551000-5
 - Produkte ushqimore të ndryshme 15800000-6
 - buke 15811100-7
- **VLERA E FONDIT LIMIT:** është 6.042.572 (gjashte milion e dyzet e dy mije e peseqind e shatedhjete e dy) leke pa tvsh dhe 7.251.087(shtate milion e dyqind e pesedhejete e nje mije e tetedhjete e shtate) lek me tvsh ndare ne lote si me poshte:
- Loti 1 “Blerje Ushqime blektoriale " me fond limit 3 492 618 (tre milion e katerqind e nentedhjete e dy mije e gjashteqind e tetembedhjete) Lekë (pa TVSH);
 - Loti 2 “Blerje ushqime koloniale” me fond limit 1 225 451(një milion e dyqind e njezetete e pese mije e katerqind e pesedhjete e nje)Lekë (pa TVSH);

- Loti 3 “Blerje Buke, fruta-perime” me fond limit 1 324 503(nje milion e treqind e njezete e kater mije e peseqind e tre)Lekë (pa TVSH);

PËRLLOGARITJA E VLERËS LIMIT TË KONTRATËS

Për përlogaritjen e vlerës limit të kontratës, mbështetur në Ligjin Nr. 162/2020, “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, si edhe VKM nr 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” sipas të cilit:

Në përlogaritjen e vlerës limit të kontratës, autoriteti kontraktor duhet t’i referohet një ose më shumë alternativave të renditura si më poshtë: **çmimet e botuara nga Instituti i Statistikave (INSTAT)**, ose/dhe çmime të tjera zyrtare, të njohura nga institucionet përkatëse (si për shembull, nga organet tatimore a doganore, dhomat e tregtisë, në manuale etj); ose/dhe

a) **çmimet e tregut; ose/dhe**

b) **çmimet e kontratave të mëparshme, të realizuara nga vetë apo nga autoritete të tjera kontraktore; ose/dhe**

ç) çmimet ndërkombëtare, të botuara.

Ne llogaritjen e fondit limit u bazuam në çmimet e Instat te derguara elektronikisht dhe per ato mallra te cilat nuk figurojne ne listen e INSTAT , u bazuam ne çmimet ne kontratat e mëparshme dhe testim tregu . Perlllogaritje e vleres se fondit limit u krye nga specialistja e fushes, ekonomiste pjese e NP.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor) **Qendra polivalente për shërbime të përkujdesit shoqëror Polican** ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

➤ AFATI KOHOR DHE GARANCITË E PRODUKTEVE

Për realizimin e mallrave dhe zbatimin e kontratës duhet të jetë **nga data e nenshkrimit te kontrates deri ne 31.12.2025** , ku furnizimi do të **kryhet sipas kerkesave te AK** , në adresen e Qendres Polivalente Polican.

LOTI I PARË: “BLERJE USHQIME BLEKTORIALE PËR QENDREN POLIVALENTE PER SHERBIME TE PERKUJDESIT SHOQEROR POLIÇAN

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9.*

Argumentimi: Ky kriter u vendos bazuar ne nenin 76 të Ligjit nr.162/2020“Për Prokurimin Publik“, dhe nenin 26 te VKM nr. 285, date 19.05.2021 ”Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik” i ndryshuar,ne te cilen eshte e percaktuar se: “1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla.”

b. *Sigurim oferte, sipas Shtojcës 4;*

Argumentimi: Ky kriter u vendos sipas nenit 83 te Ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, ne te cilen eshte e parashikuar se:

Pika 1 Neni 83: Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël.

Pika 2 Neni 83: Autoriteti ose enti kontraktor duhet të specifikojë në dokumentet e tenderit:

a) *vlerën e kërkuar të sigurimit të ofertës, e cila duhet të jetë 2% e vlerës së përllogaritur të kontratës;*

b) *çdo kërkesë për natyrën dhe formën e sigurimit të ofertës, si dhe ne nenin 30 te VKM nr.285 date 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik” i ndryshuar.*

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

Operatori ekonomik duhet të paraqesë Liçensë nga QKL, Kodi II.1.A(1) Prodhim, perpunim shperndarje me shumice e ushqimeve per njerez dhe Kodi II.1.B, Shitje me shumice e ushqimeve me origjine shtazore (per njerez).

- Nuk lejohet përdorimi i licencës se një operatori tjetër ekonomik sipas Rekomandimit të përbashkët të APP-së dhe AKU-së të datës 19.11.2018).

Argumentimi:Kërkesat e mësipërme bazohen në **nenin 77 pika 1/a dhe 2** të ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik¹” në të cilët përcaktohet se, citojmë: “1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: a) përshtatshmërinë për

të kryer veprimtarinë profesionale;... **2. Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionalë ose tregtarë.**”, në piken 5 /a të nenit 40 të VKM nr.285 date 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, në të cilën është e përcaktuar se: **5. Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon:** a) **licencat profesionale për prodhimin dhe ose furnizimin e mallrave, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore, si dhe bazuar në Rekomandimin e përbashkët të APP-se dhe AKU-se nr.10181 prot, date 19.11.2018 “Rekomandim mbi hartimin e kriterëve të veçanta për kualifikim dhe specifikimet teknike për prokurimin e produkteve ushqimore”.**

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në Vendimin “Për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet qendrës kombëtare të licencimit (QKL) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta”. Me anë të këtij kriteri kërkohej që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se prodhuesit e këtyre mallrave ushtrojnë aktivitetin e tyre sipas kriteve ligjore në fuqi, duke garantuar cilësinë e produktit.

Paraqitja e licences është kërkuar për të vërtetuar se operatori ekonomik ushtron aktivitet të rregullt në përputhje me legjislacionin në fuqi për fushën e sigurisë ushqimore dhe mbrojtjes së konsumatorit. Ky kriter është vendosur me qëllim që të shërbejë AK për të siguruar për cilësinë e ushqimit për personat e akomoduar në qendren polivalente Polican .

Njësia e prokurimit përcaktoj kriteret për kapacitetet profesionale si më lart duke qënë se këto kriterë janë të detyrueshme, janë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me objektin e kontratës. Por edhe sepse mbi të gjitha ato i shërbejnë autoritetit tonë kontraktor për njohjen e aftësisë profesionale, kualifikimeve dhe besueshmërinë e operatorëve ekonomikë në lidhje me garantimin e zbatimit në veprimtarinë e tyre të standarteve kombëtare dhe ndërkombëtare.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare 2021, 2022, dhe 2023, të konfirmuara me vulë pranë autoriteteve përkatëse (Administratës Tatimore), dhe të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabël të Autorizuar, vetëm në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të ligjit Nr.10 091, datë 05.03.2009, ku bilancet e dy viteve të njëpasnjëshme, nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivit.

Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga secili anëtar i bashkimit

2.2.2 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2021, 2022, dhe 2023, ku vlera e xhiron në të paktën 1 (një) nga vitet e periudhës së kërkuar, duhet të jetë jo më e vogël se 40 % e fondit limit të kontratës që prokurohet.

Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit, në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

2.2.3 Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të ketë shlyer taksat vendore për vitin 2024 për adresën ku ai ushtron aktivitet sipas Ekstraktit Historik lëshuar nga QKR, sipas përcaktimeve të ligjit nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, ku nëse kualifikohet, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, duhet të paraqesë vërtetim/e lëshuar nga Bashkia me anë të së cilit të vërtetohet shlyerja e këtyre taksave sipas vetëdeklarimit të kryer në shtojcën 9 të DST-së.

Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga secili anëtar i bashkimit

Argumentimi:

Kërkesat e mësipërme bazohen në **nenin 77 pika 1/b dhe 3** të ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik¹” në të cilët përcaktohet se, citojmë: “1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: **b) gjendjen ekonomike dhe financiare;**... 3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën. **Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitet dhe pasivitet. Xhiroja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës.**”

Në **nenin 43** “Kërkesat për kapacitetet ekonomiko - financiare” të vendimit të Këshillit të Ministrave me nr. **285, datë 19.5.2021** “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar) ndër të tjerash përcaktohet se, citojmë: “1. Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, **kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare.**”

2. Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë: **c) 40 % të vlerës së përlllogaritur të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar, dhe në procedurat e prokurimit “Shërbim konsulence”.**

4. Nëse vlerësohet, autoriteti/enti kontraktor mund të kërkojë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore, për një periudhë maksimumi tre vitet e fundit financiare, që të tregojnë raportet, ndërmjet aktivitet dhe pasivitet. **Nëse kërkohen një ose dy bilance, kërkesa konsiderohet e përmbushur nëse në bilancin/et e kërkuara nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitet dhe pasivitet.**

Në mbështetje të përcaktimeve ligjore dhe nënligjore të sipërcituara, autoriteti kontraktor vlerëson se:

Referuar ligjit nr.25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, ligjit nr.8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat” (i ndryshuar) neni 29 i tij, ligjit nr. 10 091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar” (i ndryshuar) neni 41 i tij, Vendimit të Këshillit të Ministrave me nr.922, datë 29.12.2014 “Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera

tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike” dhe Udhëzimit nr. 5, datë 30.01.2006 “*Për tatimin mbi të ardhurat*” (i ndryshuar) pika 3.12 e tij, autoriteti kontraktor gjykon që të kërkojë xhiron vjetore në një vlerë, jo më pak se 40 % e vlerës së parashikuar të kontratës që prokurohet dhe pasqyrat financiare për tre vitet e fundit (2021,2022,2023) pasi tatimpaguesit (operatorët ekonomikë) kanë detyrimin që të dorëzojnë në administratën tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës bilancin kontabël së bashku me anekset e tij me kushtin që në dy bilance të njëpasnjëshme të mos kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivit, si dhe Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabël të Autorizuar në rastet kur plotësohen kushtet e parashikuara nga ligji.

Po ashtu, njësia e prokurimit gjykon se bazuar në ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “*Për sistemin e taksave vendore*” (i ndryshuar), si dhe faktit ku në zbatim të legjislacionit në fuqi, Qendra Kombëtare e Biznesit ka funksion të mbajë regjistrin tregtar dhe për qëllim të regjistrimit fiskal, në të cilin përcaktohen dhe vendet e ushtrimit të operatorëve ekonomikë, duke qënë se këto të fundit kanë detyrimin të paguajnë të gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore, në vendet që ushtrojnë aktivitetin e tyre, atëherë operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të vërtetojnë se i kanë likujtuar këto detyrime nëpërmjet paraqitjes së vërtetimit të lëshuar nga Administrata e Qeverisjes Vendore.

Njësia e prokurimit përcaktoj kriteret për kapacitetet ekonomike dhe financiare si më lart duke qënë se këto kriteret janë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me objektin e kontratës, dhe se i shërbejnë autoritetit tonë kontraktor për njohjen e gjendjes financiare të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen me sukses të kontratës.

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 20 % e vlerës së fondit limit të kontratës që prokurohet.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe/ose fatura tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara,

b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë faturat përkatëse tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit, në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

Argumentimi :Operatori ekonomik duhet të paraqesë Dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave të mëparshme, të ngjashme, në një vlerë jo më të vogël se 20% të vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet , dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

1. Vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara
2. Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara

Kërkesat e mësipërme bazohen në **nenin 77 pika 4** të ligjit nr.1862/2020 “Për Prokurimin Publik” në të cilët përcaktohet se, citojmë: “4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.

Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.”

Në **nenin 40** “Kërkesat të veçanta për kontratat e mallrave” **pika 4** të vendimit të Këshillit të Ministrave me nr. **285, datë 19.5.2021** “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar), ndër të tjerash përcaktohet se, citojmë: “4. Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave të mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit. Në çdo rast, vlera totale e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 40% të vlerës së përlllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Autoriteti/enti kontraktor si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.”

Në **nenin 55** “Procedurë e hapur e thjeshtuar” **pika 4/b** të vendimit të Këshillit të Ministrave me nr. **285, datë 19.5.2021** “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar), ndër të tjerash përcaktohet se, citojmë: 4. Në këtë lloj procedure prokurimi, autoritetet kontraktore duhet

të mbajnë në konsideratë të përcaktojnë kritere të thjeshtuara pranimi, me qëllim nxitjen e pjesëmarrjes së biznesit të vogël dhe të mesëm.

*Lidhur me kërkesat për përvojën e ngjashme, vlera e kërkuar në procedurat e thjeshtuara duhet të jetë: **b) Për kontratat e mallrave dhe shërbimeve vlera totale e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 20% të vlerës së përlllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.***

Njësia e Prokurimit nga interpretimi literal i kësaj norme juridike vlerëson se edhe këto kritere janë të detyrueshme për t'u vendosur në DST. Fjala “**kërkon**” nënkupton se këto kriteret janë kritere detyrues, dhe si të tilla duhet të vendosen në DST-në e prokurimit me objektin e mësipërme.

Njësia përcaktoj kriteret për furnizime të ngjashme si më lart duke qënë se këto kritere janë të detyrueshme, janë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me objektin e kontratës.

Sipas këtij neni, Njësia vlerëson se duhen kërkuar dokumentacioni ligjor sipas parashikimit të pikës 4/b të nenit 55 që provon kryerjen e furnizimeve të ngjashme.

2.3.2 Vertetim për numrin mesatar të punonjësve për periudhën kohore 3 (tre) muajt e fundit të deklaruar, jo më i vogël se 5 punonjës, i vertetuar nga organet tatimore për të mundësuar realizimin e kontratës me sukses, ndër të cilët 2 shofera dhe 3 punëtorë krahu të pasqyruara në listepagesa me kodin përkatës.

Ne lidhje me këto pike të paraqitet: Vertetim nga administrata tatimore për numrin e punonjësve të siguruar si dhe listepagesat për secilin muaj.

Disponimi i punonjësve si me sipër do të deklarohet në seksionin përkatës të Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit sipas shtojcës 9 në DST, si dhe në rast se kualifikohet, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afatëve të ankimit, duhet të paraqesë dokumentacionin e kërkuar më lart.

Ky kriter përmbushen nëpërmjet paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9 të DST

Argumentimi : Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë fuqinë e nevojshme jo më i vogël se 5 pesë punonjës ndër të cilët 2 shofera dhe 3 punëtorë krahu të pasqyruara në listepagesa me kodin përkatës.

Kriteri i vendosur për disponimin e numërit minimal prej 5 punonjësish, është në zbatim të nenit 77 pika 4 e LPP-së, dhe nenit 40 pika 5/c, ku numri i punonjësve i kërkuar është në përputhje me përmasat dhe specifikat e kontratës. Në përlllogaritjen e numrit të punonjësve, autoriteti kontraktor ka marrë parasysh numrin e personelit që nevojitet për realizimin e objektit sipas kushteve të parashikuara në Shtojcën 6 “*Formulari i Specifikimeve teknike*” dhe afatit të ekzekutimit të përcaktuar në dokumentat e tenderit, ku në zbatim të nenit 77 pika 5 të LPP-së, dhe ligjit nr.8438, datë 28.12.1998 “*Për tatimin mbi të ardhurat*” (i ndryshuar), Vendimit të Këshillit të Ministrave me nr.922, datë 29.12.2014 “*Për deklarimin e detyrueshëm të deklarave tatimore dhe të*

dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike”, si dhe Udhëzimit nr. 5, datë 30.01.2006 “*Për tatimin mbi të ardhurat*” (i ndryshuar), njësia e prokurimit ka përcaktuar dokumentat konkret që duhet të paraqiten nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës për përmbushjen e këtyre kushteve.

2.3.3 Operatori ekonomik duhet të disponojë certifikatat e meposhtme, të leshuara nga institucionet perkatese të akredituara nga DPA:

1. **ISO 22000:2018** (per sistemin e manaxhimit të sigurisë së ushqimore, e vlefshme) ose ekuivalente
2. **ISO 9001:2015** (per sistemin e manaxhimit të cilësisë, e vlefshme) ose ekuivalente

Certifikatat duhet të jenë në fuqi, të vlefshme në kohën e zhvillimit të procedurës dhe të jenë të leshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtar akreditues të njohura nga Republika e Shqipërisë.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 79, pika 1 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, në pikën 1 të nenit 44të VKM nr.285 datë 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, në të cilën është përcaktuar se: *1. Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të leshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit, si dhe bazuar në Rekomandimin e përbashkët të APP-se dhe AKU-se nr.10181 prot, datë 19.11.2018 “Rekomandim mbi hartimin e kriterëve të veçanta për kualifikim dhe specifikimet teknike për prokurimin e produkteve ushqimore”.* Kjo kërkesë dëshmon se mbajtësi i saj garanton standardet ndërkombëtare të menaxhimit të cilësisë së ushtrimit të aktivitetit tregtar të tij.

2.3.4 Ofertuesi të paraqesë:

a) **Ambiente frigoriferike** në pronësi ose në përdorim sipas kontratës noteriale apo kontrate bashkepunimi me sipërfaqe jo më pak se 5 m², për sa më sipër të paraqitet:

- licence nga QKL me kodin II.1.B
- akt-miratim higjieno sanitar
- certifikata e mbrojtjes nga zjarri
- raport analizen e ujit të rrjetit
- certifikatën e dezinfektimit 3D
- foto të ambienteve të ushtrimit të aktivitetit
- deklaratë nga ana e operatorit ekonomik që ambienti i disponuar prej tij është me sipërfaqe minimale 50 m² dhe ku ambienti frigoriferik është jo më pak se 5 m².

b) Furre buke në pronësi ose në përdorim sipas kontratës noteriale, apo kontrate bashkepunimi të pajisur me leje higjieno sanitare, license QKL me kodin II.1.A.(1), certifikaten e dezinfektimit 3D, certifikaten e mbrojtjes nga zjarri si dhe raport analizen e ujit të rrjetit. Për produktin e mesiperm në rastin kur operatori nuk e ka në pronësi/perdorim duhet që të vertetojë me marrëveshje bashkepunimi të zyrtarizuar ose kontrate furnizimi noteriale me një subjekt prodhues e cila të tregojë qartë lidhjen e zyrtarizuar midis ofertuesit dhe prodhuesit ku ky i fundit duhet të përmbajë të dhëna të plota si: license, telefon, email, website, etj, kjo e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi.

c) Njësi prodhimi bulmeti në pronësi ose përdorim, sipas kontratës noteriale apo kontrate bashkepunimi për të gjithë periudhën e zbatimit të kontratës, të pajisur me: leje higjieno sanitare, Leje mjedisore me kodin III.1.B (për trajtimin dhe përpunimin e qumështit), License leshuar nga Qendra Kombëtare e Licensimit (QKB) me kodin II.1.A.(1) dhe II.1.B si dhe Certifikaten e dezinfektimit 3D. Për produktin e mesiperm në rastin kur operatori nuk e ka në pronësi/perdorim duhet që të vertetojë me marrëveshje bashkepunimi të zyrtarizuar ose kontrate furnizimi noteriale e cila të tregojë qartë lidhjen e zyrtarizuar midis ofertuesit dhe prodhuesit ku ky i fundit duhet të përmbajë të dhëna të plota si: license, telefon, email, website, etj, kjo e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi.

d) Thertore në pronësi/perdorim të pajisur me: leje higjieno sanitare, Leje mjedisore me kodin III.1.B (therje kafshesh), License leshuar nga Qendra Kombëtare e Licensimit (QKL) me kodin II.1.A.(1) (thertore). Për thertoren të paraqitet vertetim nga AKU që thertorja është funksionale (në kuader të nismave qeveritare në këto fushë). Për produktin e mesiperm në rastin kur operatori nuk e ka në pronësi/perdorim duhet që të vertetojë me marrëveshje bashkepunimi të zyrtarizuar ose kontrate furnizimi noteriale e cila të tregojë qartë lidhjen e zyrtarizuar midis ofertuesit dhe prodhuesit ku ky i fundit duhet të përmbajë të dhëna të plota si: license, telefon, email, website, etj, kjo e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi.

dh) Kompleks stallor në pronësi/perdorim sipas kontratës noteriale apo kontrate bashkepunimi të pajisur me Leje mjedisore me kodin III.1.B (mbareshtim kafshesh), License leshuar nga Qendra Kombëtare e Licensimit (QKL) me kodin II.3.C. Për kompleksin stallor në rastin kur operatori nuk e ka në pronësi/perdorim duhet që të vertetojë me marrëveshje bashkepunimi të zyrtarizuar ose kontrate furnizimi noteriale e cila të tregojë qartë lidhjen e zyrtarizuar midis ofertuesit dhe prodhuesit ku ky i fundit duhet të përmbajë të dhëna të plota si: license, telefon, email, website, etj, kjo e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi.

e) Kompleks pularie në pronësi/perdorim sipas kontratës noteriale apo kontrate bashkepunimi të pajisur me Certificate ose dokument pronësie, License leshuar nga Qendra Kombëtare e Licensimit (QKL) me kodin II.1.A.1 (prodhim, ambalazhim, etiketim e shpërndarje me shumicë e vezeve), Licence me kodin II.3.A (Mbarështimi i kafshëve në fermat agroblegtorale të mëdha), si dhe Leje mjedisore me kodin III.1.B (Rritje intensive e shpendeve). Për kompleksin e pularisë në rastin kur operatori nuk e ka në pronësi/perdorim duhet që të vertetojë me marrëveshje bashkepunimi të zyrtarizuar e cila të tregojë qartë lidhjen e zyrtarizuar ose kontrate furnizimi noteriale midis ofertuesit dhe prodhuesit ku ky i fundit duhet të përmbajë të dhëna të plota si: license, telefon, email, website, etj, kjo e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikim.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, në pikën 5 /ç të nenit 40 të VKM nr.285 date 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, në të cilën është e përcaktuar se:
5. Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon: ç) mjetet dhe pajisjet teknike që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën, të

nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit, si dhe bazuar në Rekomandimin e përbashkët të APP-se dhe AKU-se nr.10181 prot, datë 19.11.2018 “Rekomandim mbi hartimin e kriterëve të veçanta për kualifikim dhe specifikimet teknike për prokurimin e produkteve ushqimore”.

Me anë të këtij kriteri AK kërkon që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion mjetet dhe pajisjet teknike (ambjente të përshtatshme për thyerjen, tregëtimin dhe magazinimin e produkteve të mishit, Magazine ushqimore dhe ambiente frigoriferike, Kompleks pularie, kompleks stallor, furre buke, Njesi prodhimi bulmeti) për të përmbushur me sukses kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, nisur edhe nga natyra e produkteve, që duhet të ruhen në kushte të përshtatshme higjieno-sanitare dhe tekniko-teknologjike me qëllim që të garantojnë sigurinë e tyre.

2.3.5 Operatori ekonomik duhet të disponojë 2 (dy) mjete transporti, nga të cilat 1 (një) frigoriferike ATV për transportin e produkteve ushqimore, në pronësi apo të marrë me qira, të vërtetuar me dokumentacionin përkatës (certifikate pronësie ose kontrate qeraje noteriale) dhe të shoqëruar me lejen higjieno-sanitare, leje qarkullimi, akt kolaudimi, sigurimin e detyrueshëm të mjetit, certifikate transporti (te paraqitet automjeti i cili pajiset me këto certifikate sipas legjislacionit në fuqi), librezat shëndetësore si dhe lejet e drejtimit të drejtuesve të mjeteve.

Disponimi i automjeteve do të deklarohet në seksionin përkatës të Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit sipas shtojcës 9 në DST, si dhe *në rast se kualifikohet, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afatëve të ankimit*, duhet të paraqesë dokumentacionin e kërkuar më lart

Argumentimi: Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë, mjetet dhe pajisjet e mëposhtme:

- Mjet transporti **ATV** frigoriferik
- Mjet transporti **ATP** jo frigoriferik

Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 5/ b), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri:

- Është kërkuar që operatorin të disponoj transport ATV frigoriferik, për të garantuar transport të përshtatshme për ruajtjen e vlerave ushqimore të produkteve.
- Është kërkuar që operatorin të disponoj transport ATP (jo frigoriferik), transporti i produkteve ushqimore të bëhet me mjete të pastra të mbrojtura nga dëmtimet dhe faktorët e tjerë atmosferikë, duke zbatuar rregullat higjieno – sanitare.
- *Për mjetet duhet të disponoj sipas Kodit Rrugor dokumentat si: Leja e qarkullimit, aktin e pronësisë (kontrata shitblerje/dhurimi/fatura shitblerje), Çertifikata e Kontrollit Teknik, sigurimin e detyrueshëm të mjetit ,certifikat transporti për ato mjete që duhet të pajisjen sipas kodit rrugor*
- -Për automjetet që nuk janë në pronësi: kontratë qiraje /huapërdorje/furnizimi të shoqëruar me aktin e pronësisë së qiradhënësit, leje qarkullimi, akt kolaudim dhe policia e sigurimit të detyrueshëm të mjeteve motorrike për automjetet.

- *Këto kritere përmbushen nëpërmjet paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9 të DST.*
- Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, në pikën 5 /ç të nenit 40 të VKM nr.285 date 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, në të cilën është e përcaktuar se: 5. *Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon: ç) mjetet dhe pajisjet teknike që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën, të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit, si dhe bazuar në Rekomandimin e perbashket të APP-se dhe AKU-se nr.10181 prot, date 19.11.2018 “Rekomandim mbi hartimin e kritereve të veçanta për kualifikim dhe specifikimet teknike për prokurimin e produkteve ushqimore”.*
- Me anë të këtij kriteri AK kërkon që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion mjetet dhe pajisjet teknike (automjet frigoriferik tip ATV për transportin e mishit, bulmetit dhe nenproduktet e tyre) për të përmbushur me sukses kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, nisur edhe nga natyra e produkteve (mishit, bulmetit dhe nenproduktet e tyre) të cilat duhet të ruhen në kushte të përshtatshme higjeno-sanitare dhe tekniko-teknologjike me qëllim që të garantojnë sigurinë e tyre. Operatori ekonomik fitues do të kryejë transportin e produkteve të mishit, bulmetit dhe nenproduktet e tyre, deri në magazinën e AK dhe njëkohësisht të garantojë ruajtjen e vlerave ushqimore të produkteve.

2.3.6 Operatori ekonomik duhet të operojë duke plotësuar standartet në fuqi për sigurinë ushqimore. Për këtë, ai duhet të paraqesë **vetdeklarim**, ku të deklarojë se nga kontrolli i fundit ka rezultuar se subjekti ushtron aktivitet konform kërkesave ligjore.

Operatori ekonomik i suksesshem, përpara shpalljes së njoftimit fituesit paraprak ka detyrimin të paraqesë dokumentacion provues, ku të provohet se nga kontrolli i fundit i AKU ka rezultuar se subjekti ushtron aktivitet konform kërkesave ligjore.

Këto kritere përmbushen nëpërmjet paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9 të DST.

Argumentimi : njësia e prokurimit në zbatim të ligjit Nr. 9863, datë 28.01.2008, *"Për ushqimin"*, i ndryshuar dhe akteve nënligjore në zbatim të tij, referuar specifikës që ka malli objekt prokurimi, vendosi që operatorët ekonomikë të paraqesin dokumentacionin për vërtetimin e inspektimit nga Autoriteti Kombëtar i Ushqimit (AKU), si dhe vetdeklarimin nga operatori ekonomik se ai përmbush standartet në fuqi për sigurinë ushqimore dhe se nga kontrolli i fundit ka rezultuar se ushtron aktivitetin konform kërkesave ligjore në fuqi, **gjë që i shërben autoritetit kontraktor për njohjen e reputacionit dhe besueshmërisë të operatorëve ekonomikë, që ata ushtrojnë veprimtarinë e tyre duke përmbushur standartet në fuqi për sigurinë ushqimore.**

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, në pikën 8, të nenit 40 të VKM nr.285 date 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik” i ndryshuar, si dhe bazuar në Rekomandimin e përbashkët të APP-se dhe AKU-se nr.10181 prot, date 19.11.2018 “Rekomandim mbi hartimin e kriterëve të veçanta për kualifikim dhe specifikimet teknike për prokurimin e produkteve ushqimore”.

Paraqitja e këtij vetedeklarimi është kërkuar për të vërtetuar se operatori ekonomik ushtron aktivitet të rregullt në përputhje me legjislacionin në fuqi për sigurinë ushqimore dhe mbrojtjes së konsumatorit. Ky kriter është vendosur me qëllim që të shërbejë AK për të siguruar cilësinë e ushqimeve, që do të prokurohen.

Loti i dytë: “Blerje Ushqime koloniale për Qendren Polivalente për Shërbime të Perkuajdesit Shoqëror Poliqan

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9;*

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4;

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

- Licence të leshuar nga Qendra Kombëtare e Licensimit, Kodi II.1.A(1) Prodhim, përpunim shpërndarje me shumice e ushqimeve për njëzë.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë licencat profesionale për prodhimin dhe/ose furnizimin e mallrave, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore.

Si dhe bazuar në Rekomandimin e përbashkët të APP-se dhe AKU-së nr.10181 prot, datë 19.11.2018 “Rekomandim mbi hartimin e kriterëve të veçanta për kualifikim dhe specifikimet teknike për prokurimin e produkteve ushqimore”

Argumentimi:Kërkesat e mësipërme bazohen në **nenin 77 pika 1/a dhe 2** të ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik¹” në të cilët përcaktohet se, citojmë: “1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;... 2. Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionalë ose tregtarë.” , në pikën 5 /a të nenit 40 të VKM nr.285 date 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, në të cilën është përcaktuar se: 5. Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon: a) licencat profesionale për prodhimin dhe ose furnizimin e mallrave, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore, si dhe bazuar në Rekomandimin e përbashkët të APP-se dhe AKU-se nr.10181 prot, date 19.11.2018 “Rekomandim mbi hartimin e kriterëve të veçanta për kualifikim dhe specifikimet teknike për prokurimin e produkteve ushqimore”.

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në Vendimin “Për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet qendrës kombëtare të licensimit (QKL) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se prodhuesit e këtyre mallrave ushtrorin aktivitetin e tyre sipas kriteve ligjore në fuqi, duke garantuar cilësinë e produktit.

Paraqitja e licences është kërkuar për të vërtetuar se operatori ekonomik ushtron aktivitet të rregullt në përputhje me legjislativën në fuqi për fushën e sigurisë ushqimore dhe mbrojtjes së konsumatorit. Ky kriter është vendosur me qëllim që të shërbejë AK për të siguruar për cilësinë e ushqimit për personat e akomoduar në qendren polivalente Polican .

Njësia e prokurimit përcaktoj kriteret për kapacitetet profesionale si më lart duke qënë se këto kriterë janë të detyrueshme, janë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me objektin e kontratës. Por edhe sepse mbi të gjitha ato i shërbejnë autoritetit tonë kontraktor për njohjen e aftësisë profesionale, kualifikimeve dhe besueshmërinë e operatorëve ekonomikë në lidhje me garantimin e zbatimit në veprimtarinë e tyre të standarteve kombëtare dhe ndërkombëtare.

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare 2021, 2022, dhe 2023, të konfirmuara me vulë pranë autoriteteve përkatëse (Administratës Tatimore), dhe të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabël të Autorizuar, vetëm në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të ligjit Nr.10 091, datë 05.03.2009, ku bilancet e dy viteve të njëpasnjëshme, nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga secili anëtar i bashkimit

2.2.2 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2021, 2022, dhe 2023, ku vlera e xhiron në të paktën 1 (një) nga vitet e periudhës së kërkuar, duhet të jetë jo më e vogël se 40 % e fondit limit të kontrates që prokurohet.

Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit, në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

2.2.3 Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të ketë shlyer taksat vendore për vitin 2024 për adresën ku ai ushtron aktivitetin sipas Ekstraktit Historik lëshuar nga QKR, sipas përcaktimeve të ligjit nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, ku nëse kualifikohet, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, duhet të paraqesë vërtetim/e lëshuar nga Bashkia me anë të së cilit të vërtetohet shlyerja e këtyre taksave sipas vetëdeklarimit të kryer në shtojcën 9 të DST-së.

Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga secili anëtar i bashkimit

Argumentimi:

Kërkesat e mësipërme bazohen në **nenin 77 pika 1/b dhe 3** të ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik¹” në të cilët përcaktohet se, citojmë: “1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: **b) gjendjen ekonomike dhe financiare;**... 3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën. **Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Xhironja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalohet dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës.**”

Në **nenin 43** “Kërkesat për kapacitetet ekonomiko - financiare” të vendimit të Këshillit të Ministrave me nr. **285, datë 19.5.2021** “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar) ndër të tjerash përcaktohet se, citojmë: “1. Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar

kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare.”

2. *Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë:*

c) 40 % të vlerës së përlllogaritur të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar, dhe në procedurat e prokurimit “Shërbim konsulence”.

4. *Nëse vlerësohet, autoriteti/enti kontraktor mund të kërkojë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore, për një periudhë maksimumi tre vitet e fundit financiare, që të tregojnë raportet, ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Nëse kërkohen një ose dy bilance, kërkesa konsiderohet e përmbushur nëse në bilancin/et e kërkuara nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.*

Në mbështetje të përcaktimeve ligjore dhe nënligjore të sipërcituara, autoriteti kontraktor vlerëson se:

Referuar ligjit nr.25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, ligjit nr.8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat” (i ndryshuar) neni 29 i tij, ligjit nr. 10 091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar” (i ndryshuar) neni 41 i tij, Vendimit të Këshillit të Ministrave me nr.922, datë 29.12.2014 “Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike” dhe Udhëzimit nr. 5, datë 30.01.2006 “Për tatimin mbi të ardhurat” (i ndryshuar) pika 3.12 e tij, autoriteti kontraktor gjykon që të kërkojë xhiron vjetore në një vlerë, jo më pak se 40 % e vlerës së parashikuar të kontratës që prokurohet dhe pasqyrat financiare për tre vitet e fundit (2021,2022,2023) pasi tatimpaguesit (operatorët ekonomikë) kanë detyrimin që të dorëzojnë në administratën tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës bilancin kontabël së bashku me anekset e tij me kushtin që në dy bilance të njëpasnjëshme të mos kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit, si dhe Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabël të Autorizuar në rastet kur plotësohen kushtet e parashikuara nga ligji.

Operatori ekonomik i suksesshem, perpara shpalljes se njoftim fituesit paraprak ka detyrimin te paraqese dokumentacion provues, ku te provohet se nga kontrolli i fundit i AKU ka rezultuar se subjekti ushtron aktivitet konform kerkesave ligjore.

Këto kriterë përmbushen nëpërmjet paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9 të DST.

Argumentimi : njësia e prokurimit në zbatim të ligjit Nr. 9863, datë 28.01.2008, *“Për ushqimin”*, i ndryshuar dhe akteve nënligjore në zbatim të tij, referuar specifikës që ka malli objekt prokurimi, vendosi që operatorët ekonomikë të paraqesin dokumentacionin për vërtetimin e inspektimit nga Autoriteti Kombëtar i Ushqimit (AKU), si dhe vetdeklarimin nga operatori ekonomik se ai përmbush standartet në fuqi për sigurinë ushqimore dhe se nga kontrolli i fundit ka rezultuar se ushtron aktivitetin konform kërkesave ligjore në fuqi, **gjë që i shërben autoritetit kontraktor për njohjen e reputacionit dhe besueshmërisë të operatorëve ekonomikë, që ata ushtrojnë veprimtarinë e tyre duke përmbushur standartet në fuqi për sigurinë ushqimore.**

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, në pikën 8, të nenit 40 të VKM nr.285 date 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik” i ndryshuar, si dhe bazuar në Rekomandimin e përbashkët të APP-se dhe AKU-se nr.10181 prot, date 19.11.2018 “Rekomandim mbi hartimin e kriterëve te veçanta per kualifikim dhe specifikimet teknike për prokurimin e produkteve ushqimore”.

Paraqitja e këtij vetedeklarimi është kërkuar për të vërtetuar se operatori ekonomik ushtron aktivitet te rregullt në perputhje me legjislacionin në fuqi për sigurinë ushqimore dhe mbrojtjes së konsumatorit. Ky kriter është vendosur me qellim që ti shërbeje AK për te siguruar cilësinë e ushqimeve, qe do të prokurohen.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara. Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim

2.4.1. Kriter për shpalljen e ofertës fituese

Bazuar në pikën 3, neni 45, Seksioni III Kërkesa të veçanta sipas tipeve të kontratave, VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” : “..Për punët/mallrat/shërbimet që kanë specifikime të thjeshta, standarde teknike të mirënjohura dhe janë lehtësisht të gjendura në treg, oferta ekonomikisht më e favorshme, bazohet në çmimin si i vetmi element i ndryshueshëm ndërmjet ofertave duke shpallur fitues ofertën ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim ”

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

1. VEZË

Veze pule bazuar në stash **IS15-85**

Treguesit *fiziko-kimik* të vezës së pulës:

- a. *Pamja e jashtme*: Normale, e pastër dhe e padëmtuar.
- b. *Dhoma e ajrit*: Lartësia, jo më shumë se 9 mm.
- c. *E bardha e vezës*: Transparente, e tejdukshme dhe e pastër pa njolla gjaku (të kontrolluar në ovoskop).
- d. *E verdha e vezës*: Kompakte e ndodhur në pozicionin qendror pak e lëvizshme. Lejohet devijim i vogël nga pozicioni qendror.
- e. *Era*: Mos të ketë erë të pazakonshme apo erë të papëlqyeshme si erë peshku, myku etj.
- f. *Masa*: Jo më pak se 50 gr.
- g. Çdo kokërr duhet të jetë e vulosur ku të përmbajë markën dhe datën e skadencës.

Ambalazhimi:

Vezet ambalazhohen në kartona fole me kapacitet 30 vezë secila .

Mbi çdo ambalazh vendoset etiketa ku shënohen: Sasitë e vezëve, të ndara sipas ndërrmarjes prodhuese me emrin, adresën dhe datën e prodhimit.

Malli duhet të shoqërohet me raport analizë origjinale sipas legjislacionit në fuqi.

Raport analiza e paraqitur duhet të përmbajë të gjithë treguesit e mësipërm.

2. MISH VIÇI

Bazuar në STASH **1441/87**, Ligji nr. **10465**, datë **29.09.2011** “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe Aktin Normativ nr.4, datë **16.08.2012** “Për përcaktimin e rregullave për therjen e kafshëve dhe tregëtimin e mishit të tyre”.

Lloji: Mish viçi i freskët

Treguesit **shqisorë:**

- a) *Pamja e jashtme:* Sipërfaqja e jashtme të jetë e mbuluar me cipë të hollë tharje dhe pas prerjes të jetë I tejdukshëm. Tendinat të jenë të ndritshme, elastike dhe të forta. Forma e trupit të jetë e rrumbullakosur.
- b) *Ngjyra:* Mish i butë me ngyrë rozë dhe i dhjamt me ngjyrë të bardhë.
- c) *Era:* e këndshme, karakteristike e llojit.
- d) *Palca e kockave :* Të mbushi plotësisht kanalën e palcës, ngjyra të jetë rozë në të verdhë, çdo pjesë të jetë e vulosur me vulën e inspektoriatit veterinar.
- e) *Karakteristika* e mishit të freskët nuk duhet të ketë erë të huaj dhe nuance jeshile në sipërfaqe.

Tregëtimi i mishit të freskët bëhet jo më parë se 6 orë nga koha e therjes në verë, ndërsa në dimër 12 orë.

Të mos ketë përqindje të madhe dhjami, transporti të bëhet me mjetet e firmës të specifikuar dhe të përshtatshme për ruajtjen e mishit gjatë transportit. Ruajtja në frigorifer. Detyrimisht mishi duhet të jetë i kontrolluar dhe i vulosur nga veterineri në çdo pjesë. Mishi duhet të thërrë në ambiente (thertore) të cilat plotësojnë standartet higjieno – sanitare dhe veterinare. Të shoqërohet me çertifikatë veterinare. Vula dhe raporti veterinar të jenë të lexueshme mirë.

3. MISH PULE (Pula të freskëta)

Treguesit **shqisorë:**

- a. *Pamja e jashtme:* Ngjyrë rozë e çelur si në të bardhë karakteristike e mishit të pulës së freskët, pa shtresa të tepërta dhjami, cilësi e parë.
- b. *Ndarja anatomike:* Mishi i pulës do të përbëhet nga të gjithë pjesët e pulës (jo vetëm kofsha ose pjesë të tjera të ndara).

Pulat të jenë të kontrolluara nga veterineri dhe të shoqëruara me çertifikatë veterinare dhe shëndetsore.

Paketimi të jetë me kuti kartoni ku të jetë shënuar pesha dhe data e skadencës.

Treguesit kimik: Në përputhje me Standartin Shtetëror Shqiptar.

4. QUMËSHT

Ligji Nr.9441, dt.11.11.2005 “Për prodhimin, grumbullimin, përpunimin dhe tregëtimin e qumështit dhe të produkteve me bazë qumështi”

Karakteristikat **organoleptike**:

- *Pamja e jashtme, ngjyra dhe konsistenca*: Qumështi i cilësisë së mirë duhet të jetë i rrjedhshëm, i njëtrajtshëm dhe jo shumë i ujshëm. Gjithashtu pa praninë e lëndëve të huaja.
Ngjyra e qumështit të jetë e bardhë me një hije të lehtë të verdhë.
- *Era* duhet të jetë e këndshme dhe specifike.
- *Shija* të jetë lehtësisht e ëmbël dhe e këndshme.

Kërkesat **cilësore**:

- a. Detyrimisht i pasterizuar dhe i sterilizuar.
- b. Gjatë përpunimit dhe tregëtimit të zbatohen rregullat higjieno sanitare e veterinare në fuqi.

Ambalazhimi, marketimi dhe etiketimi

- Qumështi duhet të jetë i ambalazhuar me kuti tetrapack në peshë 1 Litër dhe i shoqëruar me Raport Analizë.
- Qumështi duhet të jetë me të dhënat, data e prodhimit, data e skadimit, përqindja e yndyrës, temperatura e ruajtjes së produktit.
- Malli duhet të shoqërohet me raport analize origjinal sipas legjislacionit në fuqi.

Ruajtja dhe transporti:

Qumështi ruhet në frigorifer në temperaturë nën 10⁰ C. Transporti bëhet me mjete frigoriferike.

5. KOS

STASH **1443-87** Urdhër i Ministrisë së Bujqësisë **Nr 645, dt. 23.12.2016**, Për zëvendësimin e aneksit I, të Urdhërit **nr. 234, datë 20.05.2014**, Për miratimin e rregullores “*Mbi kriteret mikrobiologjike për produktet ushqimore*”

Kërkesat **cilësore**

- a. *Ngjyra*: e bardhë, në sipërfaqe e bardhë lehtësisht në krem.
- b. *Strukturta*: e ngjeshur, pa pore, në prerje pa shtresa dhe ndarje hirre.
- c. *Era dhe shija*: e këndshme, karakteristike e kosit të ëmbël, lehtësisht e thartë

Ambalazhimi, marketimi dhe etiketimi

- a. Kosi ambalazhohet në paketim tetrapack, shishe qelqi ose plastike, me grykë të gjerë.
- b. Ambalazhet që përdoren të jenë në gjendje të mirë, të pastër, të thata dhe pa erë të huaj.
- c. Materiali që përdoret për ambalazhim duhet të jetë sipas normave teknike dhe higjienosanitare nga standardet përkatëse.

- d. Në çdo paketim vendoset etiketa ku shënohet: data e prodhimit, data e skadimit, standarti në fuqi.

Ruajtja dhe transporti:

Kosi ruhet e tregëtohet në frigorifer në temperaturë nën 10⁰ C dhe në mungesë të tyre mbahet në mjedis të freskët dhe të ajrosur. Transporti bëhet me mjete të mbuluara, të pastra ose me mjete frigoriferike.

Raport analiza e paraqitur duhet të përmbajë të gjithë treguesit e mësipërm. Raport Analiza “Fiziko-Kimike” dhe “Raport Analiza Mikrobiologjike” duhet të paraqiten në original, ose fotokopje të noterizuara.

6. BUKË ME MIELL GRURI

Bazuar në STASH 1411\87

Kërkesat cilësore të bukës me miell gruri me rreze 75%

Treguesit shqisorë:

- *Korja:* E lëmuar, pa flluska, pa çarje e pjesë të djegura dhe pa shkëputje të saj nga tuli. Me ngjyrë të njëllote mjalti në të kuqërremtë.
- *Tuli :* Masë e njëllote e pjekur mirë, jo e ngjitshme, me pore të shpërndarë në mënyrë të njëllote dhe pa gjurmë mielli të pabrumosura. Konsistenca elastike, jo i thërmueshëm, pa shtresa.
- *Era dhe shija:* E këndshme e bukës së pjekur mirë, pa erë dhe shije të hidhur, të thartë, myku ose të huaj. Nuk lejohet kërcitje.
- *Forma:* E rregullt, pa shtypje e deformime.
- *Lëndët e huaja:* Nuk lejohen.

Treguesit fiziko kimik:

Në përputhje me Standartin Shtetëror Shqiptar.

Lagështira në % jo më shumë se 45.

Poroziteti në % jo më pak se 70.

Aciditeti në gradë jo më shumë se 4.5.

Amballazhimi:

Çdo bukë të futet në qese letre e pastaj në qese telefoni me masën 1000 gr, këto të futura në kuti kartoni. Buka dërgohet për konsum jo më parë se 3 orë nga koha e pjekjes. Buka duhet të jetë e prerë në feta.

Transporti i bukës:

Bëhet me mjete të pastra të mbrojtura nga dëmtimet e faktorët e tjerë atmosferik duke zbatuar rregullat higjeno-sanitare për transportimin e produkteve ushqimore.

7. SHEQER

Bazuar në STASH 1413-87

I. Treguesit Organo-Leptikë

- a. Pluhur i përbërë nga kristale të imta dhe të njëjta, pa lëndë të huaja, i derdhur, i thatë në të prekur dhe të mos ngjitet.
- b. Ngjyra: e bardhë dhe me shkëlqim.
- c. Shija dhe era: Shije e ëmbël, pa shije dhe erë të huaj kur është kristal dhe kur tretet në ujë të pastër.
- d. Tretshmëria: Të tretet plotësisht në ujë, tretësira e tejdukshme dhe pa ngjyrë.

II. Ambalazhimi

- Ambalazhimi: I paketuar me pako letre me peshë 1 kg, i etiketuar.

Markerimi:

- ❖ Peshë neto ose vëllimi i produktit.
 - ❖ Data e prodhimit.
 - ❖ Data e skadimit.
 - ❖ Kushtet e veçanta të ruajtjes.
 - ❖ Rekomandime për përdorim, nëse këto ndikojnë në mënyrë të ndjeshme mbi afatet e ruajtjes së cilësisë ose mbi vlerat e produktit ushqimorë, këto të dhëna të jepen mbi ambalazh ose mbi etiketë.
 - ❖ Malli të shoqërohet me certifikatë origjine dhe raportë analize të laboratorit.
- Raport analiza e paraqitur duhet të përmbajë të gjithë treguesit e mësipërm.

8. MAKARONA

Bazuar në STASH 1170/87

I. Treguesit Organiko-Leptike

Forma: Makarona (fusilli), spirale, spageti dhe makarona të vogla.

Pamja e jashtme: Në formë të rregullt, të plota, me sipërfaqe të lëmuar deri lehtësisht të ashpër.

Pas zierjes makaronat të jenë elastike, të mos qulloren, të mos çahen dhe të mos krijojnë shkurçime.

Ngjyra: E bardhë me nuancë të verdhë, në thyerje qelqore.

Era dhe shija: E mirë karakteristike e makaronave pa shije të hidhur apo të thartë e të mykur dhe pa çfarëdo ere dhe shije tjeter të huaj.

II. Treguesit Fiziko-kimikë

Rritja e vëllimit pas zierjes jo më pak se 2 herë.
Insekte dhe dëmtues të tjerë nuk lejohen.

III. Ambalazhimi dhe etiketimi

Makaronat të jenë të ambalazuara me qese polietileni nga 0.5 deri 1 kg, të mos jenë të miellëzuara, të tregohet koha e zierjes dhe tregues të tjerë:

Markerimi:

Emri i produktit
Pesha neto
Data e prodhimit
Data e skadimit
Kushtet e veçanta të ruajtjes

Rekomandime për përdorim, nëse këto ndikojnë në mënyrë të ndjeshme mbi afatet e ruajtjes së cilësisë ose mbi vlerat e produktit ushqimorë, këto të dhëna të jepen mbi ambalazh ose mbi etiketë. Malli duhet të shoqerohet me raport analizë të rregullt sipas legjislacionit në fuqi.

Raport analiza e paraqitur duhet të përmbajë të gjithë treguesit e mësipërm.

Raport Analiza duhet të paraqitet në origjinal ose fotokopje të noterizuar.

9. ORIZ

Bazuar në STASH 1738-87

I. Treguesit Organo-Leptikë.

Pamja e jashtme: Kokrra të shëndosha, të pastra, të zhveshura tërësisht nga lëvozhga e orizit, pa shije dhe erë myku ose prishje.

Ngjyra: E bardhë, lejohen kokrra me nuancë ngjyrë të verdhë.

Era dhe shija: Karakteristike e orizit të shëndoshë, pa shije të thartë, të hidhur, pa erë myku apo erë tjetër të huaj.

II. Treguesit Fiziko – Kimikë.

1. Lageshtia 12.8 %
2. Aciditeti 0.081%
3. Lëndë të huaja jo më shumë se 0,4%.
4. Kokrra të thyera më të vogla se gjysma jo më shumë se 12%.
5. Lëndë minerale nuk lejohen.
6. Kokrra të verdha jo më shumë se 4 %.
7. Kokrra të pazhveshura nuk lejohen

III. Ambalazhimi

Ambalazhimi i paketuar në qese, me peshë 1 kg, i etiketuar, me afat skadimi deri në 1 vit, i shoqëruar me fletë analize.

- Orizi i cilësisë së parë duhet të ketë më pak se 30% të kokrrave të copëtuara, të mos jenë të miellëzuara.

Markerimi:

- ❖ Emërtimi i prodhuesit
- ❖ Emri i produktit
- ❖ Pesha neto ose vëllimi i produktit
- ❖ Data e prodhimit
- ❖ Data e skadimit
- ❖ Kushtet e veçanta të ruajtjes
- ❖ Rekomandime për përdorim, nëse këto ndikojnë në mënyrë të ndjeshme mbi afatet e ruajtjes së cilësisë ose mbi vlerat e produktit ushqimorë, këto të dhëna të jepen mbi ambalazh ose mbi etiketë.
- ❖ Malli të shoqërohet me çertifikatë origjine dhe raportë analize të laboratorit.
- ❖ Raport analiza e paraqitur duhet të përmbajë të gjithë treguesit e mësipërm.

10. FASULE

Bazuar në STASH 1743-87

I. Treguesit **Organo-Leptikë**

Pamja e jashtme : Kokrra të plota, të shëndosha, me formë dhe madhësi sipas llojit (ovale, e rumbullakët, e gjatë etj) me gjatësi 8–13mm

Ngjyra: E bardhë.

Era dhe shija: Pa erë myku dhe çfarëdo ere tjetër të huaj. Pas zierjes të ketë erë të këndshme, shije të hidhur ose çfarëdo ere tjetër të huaj.

II. Treguesit **Fiziko Kimikë**

1. Lagështia 11.2%
2. Lëndë të huaja jo më shumë se 0.8%
3. Kokrra të thyera jo më shumë se 13%
4. Përzierje kokrrash jo më shumë se 2.2%
5. Dëmtime mekanike nuk lejohen.
6. Infeksione ose dëmtime nga insektet nuk lejohen.

III. Ambalazhimi

- Ambalazhimi i paketuar me peshë 1 kg, me etiketën përkatëse ku të shënohet prodhuesi, data e prodhimit dhe skadencia (deri në një vit).

Markerimi:

- ❖ Emërtimi i prodhuesit.
 - ❖ Emri i produktit
 - ❖ Pesha neto ose vëllimi i produktit
 - ❖ Data e prodhimit
 - ❖ Data e skadimit.
 - ❖ Kushtet e veçanta të ruajtjes.
 - ❖ Rekomandime për përdorim, nëse këto ndikojnë në mënyrë të ndjeshme mbi afatet e ruajtjes së cilësisë ose mbi vlerat e produktit ushqimorë, këto të dhëna të jepen mbi ambalazh ose mbi etiketë.
- Malli të shoqërohet me çertifikatë origjine dhe raportë analize të laboratorit.
Raport analiza e paraqitur duhet të përmbajë të gjithë treguesit e mësipërm.

11. VAJ ULLIRI

Ligji **nr. 87/2013**, “Për kategorizimin e prodhimit, emërtimin dhe tregëtimin e vajit të ullirit dhe vajit të bërsisë së ullirit” Vendim i Këshillit të Ministrave **nr. 235, datë 21.3.2017** Për miratimin e rregullores “Për karakteristikat e cilësisë dhe kriteret e natyrshmërisë së vajit të ullirit dhe vajit të bërsive të ullirit”

Vaji i Ullirit është vaj i cili ka aciditet të lirë, të shprehur si acid oleik, jo më shumë se 2 gramë për 100 gramë dhe karakteristika si më poshtë:

I. Treguesit organo leptike:

- Pamja e jashtme të jetë e kthjellët dhe pa asnjë turbullirë.
- Ngjyra të jetë e verdhë deri në lehtësisht jeshile.
- Era dhe shija karakteristike të vajit të ullirit.
- Nuk duhet të përmbajë lëndë të huaja.
- Nuk duhet të jete i rafinuar.
- Ambalazhimi në shishe 1 Litërshe qelqi ose plastike transparente me etiketë ku të shënohen standardet.
- Nuk duhet të jetë i përzier me vajra të tjera dhe konservante.

II. Markerimi:

- Emërtimi i prodhuesit
- Emri i produktit
- Pesha neto ose vëllimi i produktit
- Data e prodhimit
- Data e skadimit
- Kushtet e veçanta të ruajtjes

- Rekomandime për përdorim, nëse këto ndikojnë në mënyrë të ndjeshme mbi afatet e ruajtjes së cilësisë ose mbi vlerat e produktit ushqimorë, këto të dhëna të jepen mbi ambalazh ose mbi etiketë.

Produkti duhet të shoqërohet me raport analizë të rregullt sipas legjislacionit në fuqi.

“Raport Analiza Fiziko-Kimike” duhet të përmbajë të gjitha treguesit e kërkuar dhe të paraqitet në origjinal, ose fotokopje të noterizuara.

12. VAJ GJELLE

Bazuar në STASH 2121-87

I. Treguesit **Organo-Leptike**

Pamja në 20⁰ C. Lëng vajor, i qartë, pa depozitime.

Ngjyra : E verdhë e lehtë.

Era dhe shija: E mirë karakteristike e vajit lule dielli, pa shije dhe erë të huaj.

II. **Ambalazhimi dhe Etiketimi**

Vaj lule dielli i rafinuar do të ambalazhohet në shishe plastike me vëllim 1 ose 5 litroshe, të mbyllura me tapë plastike dhe hermetike.

Mbi çdo shishe do të vendoset etiketa në të cilën do të shënohet:

Emertimi i plotë i mallit dhe data e prodhimit.

Markerimi:

- ❖ Emërtimi i prodhuesit
- ❖ Emri i produktit
- ❖ Pesha neto ose vëllimi i produktit
- ❖ Data e prodhimit
- ❖ Data e skadimit
- ❖ Kushtet e veçanta të ruajtjes

Rekomandime për përdorim, nëse këto ndikojnë në mënyrë të ndjeshme mbi afatet e ruajtjes së cilësisë ose mbi vlerat e produktit ushqimorë, këto të dhëna të jepen mbi ambalazh ose mbi etiketë. Data e skadimit ose afati i përdorimit që do të jetë 18 muaj nga data e prodhimit dhe e furnizimit në institucion. Shishet do të ambalazhohen në kuti kartoni të mbyllura mirë. Malli të shoqërohet me certifikatë origjine dhe raportë analize të laboratorit. Raport analiza e paraqitur duhet të përmbajë të gjithë treguesit e mësipërm.

13. MIELL GRURI

Bazuar në STASH 1455\87

Lloji: Miell Gruri me rreze 80 %

I. Treguesit **shqisor:**

Ngjyra : e bardhë me nuancë të lehtë në të verdhë në varësi të llojit të grurit.

Pjesëzat e himeve janë të padukshme me rreze 80 %.

Era dhe shija: karakteristikë e miellit të grurit, pa erë myku, pa shije të hidhur e të thartë.

II. Treguesit Fizikë Dhe Kimikë

- Lagështira (%) jo më shumë se 14.
- Aciditeti i shprehur në acid sulfurik në lëndët absolutisht të thata (%) jo më shumë se 0.115.
- Hiri i tretshëm, në lëndën absolutisht të thatë(%) jo më shumë se 0.9.
- Hiri i patretshëm në acid klorhidrik 10%; në lëndën absolutisht të thatë(%) jo më shumë se 0.1.
- Mbisitja(imtesia e bluarjes): Për miellrat e bluar në fabrikat me cilindra:
në sitën metalike nr.54(%) jo më shumë se 2.
- Në sitën e mëndafshtë 5 xxx(%) jo më shumë se 5.
- Gluteni i njomë(%) jo më pak se 25.
- Lëndë minerale nuk lejohen.
- Përzjerje metalike: plumbi, zinku e bakri nuk lejohen.
- Lejohet përmbajtja e hekurit në formë thërmijash nën 0.3 mm, jo më shumë se 3mg/g.
- Mikroorganizmat patogjen nuk lejohen.

III. Ambalazhimi dhe transportimi.

Ambalazhimi në pako letre me peshe 1kg. Mbi ambalazh vendoset etiketa ku shënohen të dhënat e mëposhtme.

Markerimi:

- ❖ Emërtimi i prodhuesit
- ❖ Emri i produktit
- ❖ Peshë neto ose vëllimi i produktit
- ❖ Data e prodhimit
- ❖ Data e skadimit
- ❖ Kushtet e veçanta të ruajtjes

Rekomandime për përdorim, nëse këto ndikojnë në mënyrë të ndjeshme mbi afatet e ruajtjes së cilësisë ose mbi vlerat e produktit ushqimorë, këto të dhëna të jepen mbi ambalazh ose mbi etiketë.

Ambalazhimi: Etiketa e produktit të ambalazhuar duhet të fiksohet në mënyrë që të mos shkëputet nga ambalazhi.

❖ Shënimet e detyrueshme të marketimit duhet të jenë të qarta, të dukshme mirë dhe lehtësisht të lexueshme në kushtet normale të blerjes dhe përdorimit.

❖ N.q.s është i mbuluar me një material veshës të gjitha informacionet e detyrueshme duhet të figurojnë mbi këtë të fundit.

Transporti të bëhet me mjete të pastra të mbrojtura nga faktorët atmosferike duke zbatuar rregullat higjeno-sanitare për transportimin e produkteve ushqimore.

Malli të shoqërohet me certifikatë origjine dhe raportë analize të laboratorit.

Raport analiza e paraqitur duhet të përmbajë të gjithë treguesit e mësipërm.

14. KRIPË GJELLE E JODIZUAR

Bazuar në STASH 1437\01.07.1995

Lloji: kripë ushqimore e përpunuar dhe e bluar për përdorim në kuzhinë.

Ngjyra : E bardhë

Era dhe shija: E kripur pa shije dhe ere të huaj.

Pamja: Masë kokrrizore.

I. Treguesit fiziko kimikë:

Imtësia në mm 0.2 – 2.

Klorur natriumi (NaCl) në lëndën e thatë në %, jo më pak se 98.

Klorur magnezi (MgCl₂) në lëndën e thatë në %, jo më shumë se 0.3.

Sulfat magnezi (MgSO₄) në lëndën e thatë në %, jo më shumë se 0.9.

Sulfat kalciumi (CaSO₄) në lëndën e thatë në %, jo më shumë se 0.2.

Lëndë të patretshme në lëndën e thatë në %, jo më shumë se 0.3.

Lagështira në %, jo më shumë se 1.

Kripa të plotësojë të gjithë kërkesat higjeno-shëndetsore dhe normat e miratuara nga Ministria e Shëndetësisë.

Ambalazhimi: Të bëhet në qese të paster ose polietileni ushqimore, pesha 1 kg.

Marketimi:

❖ Emërtimi i prodhuesit

❖ Emri i produktit

❖ Peshë neto ose vëllimi i produktit

❖ Data e prodhimit

- ❖ Data e skadimit
- ❖ Kushtet e veçanta të ruajtjes
- ❖ Rekomandime për përdorim, nëse këto ndikojnë në mënyrë të ndjeshme mbi afatet e ruajtjes së cilësisë ose mbi vlerat e produktit ushqimorë, këto të dhëna të jepen mbi ambalazh ose mbi etiketë

Ambalazhimi: Etiketa e produktit të ambalazhuar duhet të fiksohet në mënyrë që të mos shkëputet nga ambalazhi.

- ❖ Shënimet e detyrueshme të marketimit duhet të jene të qarta dhe lehtësisht të lexueshme në kushtet normale të blerjes dhe përdorimit.
 - ❖ N.q.s është i mbuluar me një material veshës të gjitha informacionet e detyrueshme duhet të figurojnë mbi këtë të fundit.
 - ❖ Emri i produktit ushqimor dhe përmbajtja neto duhet të bjerë në sy që në pamje të parë.
 - ❖ N.q.s gjuha në etiketën origjinale nuk është e pranueshme për konsumatorin për të cilin ajo është e destinuar, duhet të përdoret një etikete shtesë që përmban informacionin e detyrueshëm në gjuhën shqipe.
 - ❖ Në rastin kur etiketa është zëvendësuar, apo plotësuar me një tjetër, shënimet e detyrueshme duhet të jenë pikë për pikë si të etiketës origjinale.
- Malli të shoqërohet me certifikatë origjine dhe raportë analize të laboratorit.
Raport analiza e paraqitur duhet të përmbajë të gjithë treguesit e mësipërm.

15. SALCË

Bazuar në STASH 1429-87

Pamja e jashtme: Me sipërfaqe të njëllajtë ku nuk lejohen shenja myku dhe fermentimi, pa fara dhe pjese te fermentuara.

Ngjyra: e kuqe, karakteristike e zarzavatit të përdorur e te ziera.

Shija dhe era: Me erë të pëlqyeshme, karakteristike e zarzavatit që mbizotëron në përzierje, pa erë të huaj. Shija të jetë e pëlqyeshme, pa shije të hidhur ose çfardo shije tjetër të huaj.

- I.** Treguesit **kimike:** Përmbajtja e ekstraktit të dobishëm 28-30%
Aciditeti jo më shumë se 0.1
Kripë NaCl në % jo me shume se 1.3

II. Ambalazhimi:

Të jetë i ambalazhuar hermetikisht në shishe qelqi, me peshë 720gr. Me etiketë:

- Markëtimi
- Emërtimi i produktit
- Emërtimi i prodhuesit
- Pështa neto ose vëllimi i produktit
- Data e prodhimit
- Data e skadimit

- Kushtet e veçanta të ruajtjes

Malli të shoqërohet me certifikatë origjine dhe raportë analize të laboratorit.
Raport analiza e paraqitur duhet të përmbajë të gjithë treguesit e mësipërm.

16. NISESHTE

I. Treguesit **shqisorë**:

Ngjyra e bardhë

Era dhe shija: karakteristikë e niseshtes së misrit, pa erë myku, pa shije të hidhur, të thartë dhe pa erë e shije të huaj.

Lagështia; % jo më shumë se 8

Aciditeti i shprehur në lëndët absolutisht të thata(%) jo më shumë se 0.100

Lëndët minerale nuk lejohen.

Mikroorganizma patogjene nuk lejohen.

Ambalazhimi dhe transportimi; në pako letre 1 kg. Mbi ambalazh vendoset etiketa ku të shënohen të dhënat e mëposhtme:

Marketimi:

Emërtimi i prodhuesit

Emërtimi i produktit

Pesha neto ose vëllimi i produktit

Data e prodhimit

Data e skadimit

Kushtet e veçanta të ruajtjes.

II. **Ambalazhimi:** Etiketa e produktit të ambalazhuar duhet të fiksohet në menyrë që të mos shkëputet nga ambalazhi.

Shënimet e detyrueshme të marketimit duhet të jenë të qarta, të dukshme mirë dhe lehtësisht të lexueshme në kushtet normale të blerjes dhe përdorimit.

N.q.s është i mbuluar me një material veshës të gjitha informacionet e detyrueshme duhet të figurojnë mbi këtë të fundit.

Emri i produktit ushqimor dhe përmbajtja neto duhet të bjerë në sy që në pamje të parë.

N.q.s gjuha në etiketën origjinale nuk është e pranueshme për konsumatorin për të cilin ajo është e destinuar, duhet të përdoret një etiketë shtese që përmban informacionin e detyrueshëm në gjuhën shqipe.

Në rastin kur etiketa është zëvendësuar , apo plotësuar me një tjetër, shënimet e detyrueshme duhet të jenë pikë për pikë si të etiketës orgjinale.

Malli të shoqërohet me certifikatë origjine dhe raportë analize të laboratorit.
Raport analiza e paraqitur duhet të përmbajë të gjithë treguesit e mësipërm.

17. LËNG LIMONI

Shija dhe era : Të jetë me erë dhe shijen e limonit të freskët.

Të jetë i ambalazhuar në shishe plastike. Në shishe të jetë e shënuar:

- Emërtimi i prodhuesit
- Emërtimi i produktit
- Pesha neto
- Data e skadimit
- Kushtet e veçanta të ruajtjes
- Malli të shoqërohet me certifikatë origjine dhe raport analize të laboratorit.

18. KAFE TURKE

Lloji: kafe turke (arabica)

Karakteristikat **organoleptike**

Ngjyra: Kafe e errët karakteristikë e kafesë së pjekur të freskët

Erë dhe shije karakteristike te kafese pa ere myku dhe ere te huaj,pa lageshtire dhe lende te huaja.

Ambalazhimi: të paketuara në pako 100gr të mbështjella me leter alumini, ku të jetë e shënuar etiketa me të dhënat e mëposhtme:

- Emërtimi i prodhuesit.
- Emri i produktit.
- Pesha neto ose vëllimi i produktit .
- Data e prodhimit dhe e skadimit dhe kushtet e veçanta të ruajtjes.
- Shënimet e detyrueshme të marketingut duhet të jenë të qarta dhe lehtësisht të lexueshme në kushtet normale të blerjes dhe të përdorimit.

**ZARZAVATET TË JENË SIPAS STINËS DUKE PËRFSHIRË TË GJITHA LLOJET SI:
DOMATE, QEPË, SPECA, PATËLLXHANA, KARROTA, PRESH, BAMJE, SPINAQ,
BARBUNJA ETJ. AMBALLAZHIMI ME QESE, PESHA SIPAS KËRKESAVE TË
AUTORITETIT KONTRAKTOR.**

19. PATATE

Bazuar në STASH 1729\88

I. Treguesit **cilësorë** të patates verore e dimërore:

Pamja e jashtme: Të plota, të forta, të pastra e të thata, jo jeshile, jo të mbira me ngjyrë dhe me sytha tipik të kultivarit.

Pjekuria: Kokrra të pjekura.

Madhësia e kokrrës (diametri më i madh) mbi: për të rrumbullaktat dimërore –5 cm; verore –4 cm. Për vezaket dimërore dhe verore 4 cm. Për të zgjaturat -3.5 cm.

Lejohen:

- a. lehtësisht të gjelbra jo më shumë se 3 % për dimëroret; 1 % për veroret;
- b. të mbira jo më shumë se 1 % për dimëroret dhe nuk lejohen për veroret;
- c. lehtësisht të vyshkura jo më shumë se 3 % për dimëroret dhe 2 % për veroret;

Nuk lejohen

- d. të çara, të prera e të plasura nga goditjet nuk lejohen;
- e. të kalbura nga lagështira vetngrohja, fitoftora, bryma, ngrica, nga sëmundje e dëmtues nuk lejohen;
- f. zgjebe me plagë deri në 1\5 e sipërfaqes së kokrrës jo më shumë se 1 % .g. njolla bojë hiri e ndryshkur deri në 1\5e sipërfaqës së kokrrës nuk lejohen;
- h. dëmtime nga krimbi jo më shumë se 1 % .
- i. Dëmtime nga doseza nuk lejohen.

20. QEPË E THATË

Bazuar në STASH 1755\88

I. Treguesit **cilësorë** të qepës së njomë dhe të thatë:

Pamja e jashtme: Me pjekuri të plotë. Me cipë e bisht të thatë, të shëndosha e të plota. Me ngjyrë e formë tipike të kultivarit dhe me gjatësi të bishtit deri në 7 cm.

Diametri: për ovalet 4-8 cm, për llojet e tjera 5-10 cm.

Dëmtime mekanike: Cifla, bishta, sëmundje, lejohen jo më shumë se 1 % dhe 1 % lëndë të huaja (cifla, bishta).

Nuk lejohen: me sëmundje, të ngrira, të kalbura e të mykura

II. Ambalazhimi dhe etiketimi bazuar në standartin 1799\88.

Transportimi i perimeve të freskta bëhet me mjete të pastra të mbrojtura nga dëmtimet e faktorë të tjerë atmosferik, duke zbatuar rregullat higjieno–sanitare për transportimin e produkteve ushqimore.

21. DOMATE

Bazuar në STASH **1726-88**

Pamja e jashtme: Të fresketa, me forme tipike të kultivarit, të plota, të pastra, të pavarura, të pashtypura, pakalbje, pa njolla nga djegia e diellit, të paprekura nga sëmundjet dhe dëmtuesit.

Pjekuria dhe ngjyra: Me pjekuri normale, me ngjyrë të kuqe, lehtësisht rozë dhe jeshile rreth bishtit.

Nuk lejohen domate të tejpkjeka, të zbutura e të vyshkura.

Nuk lejohen: dëmtime e sëmundje, të plasura e të vrara lehtësisht.

Për llojet e mesme dhe të vona lejohen deri në 5% plasaritje rreth bishtit por pa rrjedhje lëngu (të kalçifikuara), madhësia e kokrrës (diametri më i madh gjerësor), jo më pak se: 5 cm për të hershmet dhe 7 cm për të mesmet dhe të vonat.

Për të mesmet e të vonat kumbullore (gjatësia 5 cm).

Ambalazhimi dhe etiketimi bazuar në standartin **1799\88**.

Transporti i perimeve të freskta bëhet me mjete të pastra të mbrojtura nga dëmtimet e faktorë të tjerë atmosferik, duke zbatuar rregullat higjieno-sanitare për transportimin e produkteve ushqimorë.

22. SPECA

Bazuar në STASH **1756\88**

I. Treguesit **cilësorë** të specës:

Pamja e jashtme: Me ngjyrë e formë tipike të kultivarit, të freskta, të pastra dhe me pjekuri teknike.

Dëmtime: Të shtypura, të gërvishtura jo më shumë se 3 %

Shija: Karakteristike e kultivarit. Lejohet shije djegëse e lehtë. Nuk lejohet përzierje e specave djegës me ato jo djegës

Gjatësia: Për të gjatat mbi 10 cm. Për të rrumbullaktat mbi 7 cm.

II. Ambalazhimi dhe etiketimi bazuar në standartin **1799\88**.

Transporti i perimeve të freskta bëhet me mjete të pastra të mbrojtura nga dëmtimet e faktorë të tjerë atmosferik, duke zbatuar rregullat higjieno-sanitare për transportimin e produkteve ushqimorë.

23. PRESH

Bazuar në STASH 1759-88.

Lloji: Presh për treg të freskët

Kërkesat Cilësore:

Pamja e jashtme: i freskët, i pastër, i njomë, me ngjyre të bardhë në jeshile, i pavyskur dhe i larë me uje të pijshem.

Diametri në pjesën më të trashë 2.5-3.5cm.

Gjatësia e kërcellit 25-45cm .

Gjatësia e gjethit nga rozeta, jo më shumë se 20cm

Sistemi rrënjor jo më shumë se 1cm.

Dëmtime e sëmundje nuk lejohen.

Ambalazhimi dhe etiketimi bazuar në standartin 1799\88.

Perimet ambalazhohen të ndara sipas kultivarve në arka të pastra të forta e të thata të prodhuara sipas standartit ose kushtit teknik përkatës në fuqi.

Çdo parti perimesh shoqërohet me etikete ku shënohet: Prodhuesi, lloji i prodhimit, cilësia, masa bruto dhe neto. Transporti i perimeve të freskta bëhet me mjete të pastra të mbrojtura nga dëmtimet e faktorë të tjerë atmosferik duke zbatuar rregullat higjieno–sanitare për transportimin e produkteve ushqimorë.

24. PATËLLXHAN

Bazuar në STASH 1730\88.

I.Kërkesat Cilësore

Pamja e jashtme: Karakteristike e kultivarit, të freskëta, të pastra, me sipërfaqe të lëmuar me ngjyrë të zezë manushaqe, me pjekuri normale, me fletë jeshile me nuanca të dobëta manushaqe, të pa vyshkura.

Nuk lejohen dëmtime të ndryshme e sëmundje, të kalbura, të mykura, të ngrira.

Madhësia në cm diametri jo më shumë se

- ❖ Per të gjatat 5cm.
- ❖ Per të rrumbullaktat 12cm.

Gjatesia e bishtit në cm jo më shumë se 4

Ambalazhimi dhe etiketimi bazuar në standartin 1799\88

Perimet ambalazhohen të ndara sipas kultivarve në arka të pastra të forta e të thata të prodhuara sipas standartit ose kushtit teknik përkatës në fuqi.

Çdo parti perimesh shoqërohet me etikete ku shënohet:

Prodhuesi, lloji i prodhimit, cilësia, masa bruto dhe neto.

Transporti i perimeve të freskta bëhet me mjete të pastra të mbrojtura nga dëmtimet e faktorë të tjerë atmosferik, duke zbatuar rregullat higjeno–sanitare për transportimin e produkteve ushqimorë.

25. BARBUNJA

Bazuar në SSH **1760:1988** ose ekuivalentin e tij.

Klasifikimi

a. Lloji: e freskët

Kërkesat cilësore

- b. Pamja e jashtme dhe ngjyra:** Të njoma, të freskëta, pa fijëzime, me ngjyrë tipike për kultivarin.
- c. Kokrra të ndezura, të shtypura e të mykura:** nuk lejohen të vyshkura.
- d. Dëmtime mekanike:** lejohen deri në 3% e partisë me dëmtime të lehta (të çara ose të thyera).
- e. Njolla ndryshku** nuk lejohen.
- f. Nga sëmundjet e solucionet kimike,** nuk lejohen.

Ambalazhimi, etiketimi, verifikimi i kërkesave cilësore, ruajtja dhe transportimi

Sipas SSH **1799:1988** “*Perime. Ambalazhimi, etiketimi, verifikimi i kërkesave cilësore, ruajtja dhe transportimi*” ose ekuivalentin e tij.

Ambalazhimi duhet të sigurojë cilësi higjenike, ushqimore, teknologjike dhe organo-leptike të produktit dhe të jetë i sigurt e i përshtatshëm për qëllimin e përdorimit.

Transporti i perimeve të freskta bëhet me mjete të pastra të mbrojtura nga dëmtimet e faktorët e tjerë atmosferik duke zbatuar rregullat higjeno–sanitare për transportimin e produkteve ushqimore.

26. BAMJE

Bazuar në SSH **1491: 1987** ose ekuivalentin e tij.

Klasifikimi:

- **Lloji:** e freskët

Treguesit **shqisorë:**

- *Pamja e jashtme*: Të freskëta, të shëndosha, të pastra, me fije normale për kultivarin dhe fara që duket lehtë, me formë të drejtë, lehtësisht të deformuar. Forma të jetë e një prizmi shumëkëndësh që ngushtohet në majë, të pa drunjëzuara e pa fijëzime.
- *Gjatësia për bamjen frutshkurtër* të jetë deri në 6 cm dhe *për atë frutgjatë* të jetë deri në 8 cm.
- *Dëmtime të ndryshme (mekanike, sëmundje nga kimikatet)*: Lejohet deri në 5% të partisë me vyshkje të lehtë. Nuk lejohet me sëmundje e dëmtues.
- *Ngjyra* të jetë tipike për kultivarin.
- *Ndërtimi i frutit*: Fruti të jetë i butë, me fara të vogla në fazën e qumështit. Lejohet me fruta të tejppjekura deri në masën 2% per cilësinë e parë.

Ambalazhimi, etiketimi, verifikimi i kërkesave cilësore, ruajtja dhe transportimi

Sipas SSH **1799:1988** “*Perime. Ambalazhimi, etiketimi, verifikimi i kërkesave cilësore, ruajtja dhe transportimi*” ose ekuivalentin e tij.

Ambalazhimi duhet të sigurojë cilësi higjienike, ushqimore, teknologjike dhe organo-leptike të produktit dhe të jetë i sigurt e i përshtatshëm për qëllimin e përdorimit.

Transporti i perimeve të freskta bëhet me mjete të pastra të mbrojtura nga dëmtimet e faktorët e tjerë atmosferik duke zbatuar rregullat higjieno–sanitare për transportimin e produkteve ushqimore.

27. SPINAQ

Bazuar në SSH **1757:1988** ose ekuivalentin e tij.

Klasifikimi

- **Lloji**: e freskët

Treguesit cilësorë

- *Pamja e jashtme*: Me gjethe të njoma e të freskëta, me ngjyrë jeshile karakteristike e kultivartit. Të lara e të pastruara me ujë të pijshëm e pa lulëzim.
- *Gjatësia e tufës, cm*:
 - o *Për spinaqin e serrës*: Mbi 30.
 - o *Për spinaqin e fushës*: Mbi 20-30.
- *Sistemi rrënjor, cm, jo më shumë se*: 1.
- *Të prekura nga sëmundjet, të vyshkura, të mykura e të kalbura*: Nuk lejohen.

Ambalazhimi, etiketimi, verifikimi i kërkesave cilësore, ruajtja dhe transportimi

Sipas SSH **1799:1988** “*Perime. Ambalazhimi, etiketimi, verifikimi i kërkesave cilësore, ruajtja dhe transportimi*” ose ekuivalentin e tij.

Ambalazhimi duhet të sigurojë cilësi higjienike, ushqimore, teknologjike dhe organo-leptike të produktit dhe të jetë i sigurt e i përshtatshëm për qëllimin e përdorimit.

Transporti i perimeve të freskta bëhet me mjete të pastra të mbrojtura nga dëmtimet e faktorët e tjerë atmosferik duke zbatuar rregullat higjieno–sanitare për transportimin e produkteve ushqimore.

**FRUTAT TË JENË SIPAS STINËS DUKE PËRFSHIRË TË GJITHA LLOJET SI:
PORTOKALLE, MOLLË, BANANE, SHALQI, PJEPEP, MANDARINA, RRUSH, ETJ.
AMBALLAZHIMI ME QESE.**

28. MOLLA

Bazuar në STASH 1752\88.

Lloji: Mollë për treg cilësia e parë.

Kërkesat cilësore:

Pamja e jashtme, pjekuria, era dhe shija: Të freskëta, me zhvillim normal, të shëndosha e me bisht. Me formë, ngjyrë e shije të kultivarit, pa deformime me 3 pjekuri teknike të njëjtë. Pa erë e shije të huaj.

Madhësia e kokrrës (prerë gjerazi, në diametrin më të madh).

- ❖ Kultivaret me kokërr të zgjatur jo më pak se 70 mm.
- ❖ Kultivaret me kokërr të rrumbullaket jo më pak se 80 mm.
- ❖ Kultivaret me kokërr të vogël jo më pak se 60 mm.

29. Dëmtime mekanike nuk lejohen.

Të prekura nga sëmundjet dhe insektet nuk lejohen.

Të kalbura, të ngrira, njolla nga *Monilia* (kalbëzimi), lëndë të huaja nuk lejohen.

Nga krimbi nuk lejohen.

Njolla të shkaktuara nga dielli në lëkurë nuk lejohen.

Gunga(kallo) njolla në lëkurë nuk lejohen.

Njolla nga solucionet kimike në sipërfaqen e kokrrës nuk lejohen.

Përmbajtja e pesticideve të jetë sipas normave të miratuara nga Ministria e Shëndetësisë.

Ambalazhimi dhe etiketimi:

Frutat ambalazhohen të ndara sipas kultivarëve në arka të prodhuara sipas standarteve dhe kushteve teknike në fuqi për çdo lloj fruti dhe të pastra.

Frutat mund të ambalazhohen edhe në qeska plasmasi ushqimore ose rrjeta ushqimore të lidhura, të qepura ose të ngjitura në grykë. Vendosen në arka në mënyrë të tillë, të cilat të ruhet freskia dhe konsistenca e frutave.

- ❖ Mbi çdo ambalazh vendoset etiketa ku shënohet:
- ❖ Firma prodhuese
- ❖ Lloji i prodhimit
- ❖ Cilësia
- ❖ Masa neto e bruto

Transporti i frutave, të freskta, bëhet me mjete të pastra të mbrojtura nga dëmtimet e faktorët e tjerë atmosferik duke zbatuar rregullat higjieno–sanitare për transportimin e produkteve ushqimore.

30. PORTOKALLE

Bazuar në STASH 1722\88.

Lloji: Portokalle për treg cilësia e parë.

Kërkesat cilësore:

Pamja e jashtme: të freskët, me zhvillim normal, të shëndoshë dhe me bisht.

Para dhe pas 15 Janarit lejohen kokrra pa bisht përkatësisht 5 dhe 20%. Me pjekuri teknike të plotë.

Ngjyra, shija dhe aroma: Ngjyrë karakteristike e kultivarit e verdhë në portokalli me erë karakteristike dhe shije të ëmbël në të athët, pa shije të hidhur.

Madhësia e kokrrës (diametri më i madh) në mm jo më pak se 70.

Dëmtime mekanike nuk lejohen.

Të prekura nga sëmundjet dhe insektet nuk lejohen.

Të kalbura, të mykura dhe të fermentuara nuk lejohen.

Lënde të huaja nuk lejohen.

Zbutje të kokrrave dhe ngrirje nuk lejohen.

Përmbajtja e pesticideve të jete sipas normave të miratuara nga Ministria e Shëndetësisë.

Ambalazhimi dhe etiketimi:

Frutat ambalazhohen të ndara sipas kultivarëve në arka të prodhuara sipas standarteve dhe kushteve teknike në fuqi për çdo lloj fruti dhe të pastra.

Frutat mund të ambalazhohen edhe në qeska plasmasi ushqimore, ose rrjeta ushqimore të lidhura, të qepura ose të ngjitura në grykë. vendosen në arka në mënyrë të tillë, të cilat të ruhet freskia dhe konsistenca e frutave.

- ❖ Mbi çdo ambalazh vendoset etiketa ku shënohet:
- ❖ Firma prodhuese
- ❖ Lloji i prodhimit
- ❖ Cilësia
- ❖ Masa neto e bruto

Transporti i frutave të freskta bëhet me mjete të pastra të mbrojtura nga dëmtimet e faktorë të tjerë atmosferik duke zbatuar rregullat higjieno–sanitare për transportimin e produkteve ushqimore.

31. BANANE

Kërkohet cilësi e parë, të freskëta, me zhvillim normal, në tufë, me pjekuri teknike të plotë:

Ngjyra të jetë jeshile në të verdhë, me erë dhe aromë të këndshme, karakteristike e ketij kultivari.

Madhësia e kokrrës të jetë mesatare.

Dëmtime mekanike nuk lejohen.

Njolla të kafta që tregojnë tejkalimin e pjekurisë nuk lejohen.

Gërvishtje të lëkurës nuk lejohen.

Zbutje të lëkurës nuk lejohen.

Amballazhimi të jetë në kuti kartoni standarte tipike për tregëtimin e bananes.

Malli të jetë i shoqeruar me etiketën e cilësisë.

Duke qënë se specifikimet teknike plotësojnë kushtet e përcaktuara në nenin 36 të ligjit **nr.162/2020, datë 23.12.2020** “Për Prokurimin publik¹”, dhe nenin 40 pika 2 të Vendimin e Këshillit të Ministrave **Nr. 285, datë 19.5.2021** “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar), njësia e prokurimit sipas detyrave specifikeve të gjithesecilit bëri hartimin e kritereve të përgjithshme dhe të vecanta sipas akteve ligjore dhe nenligjore.. Dokumentat u printuan dhe u firmosën në çdo faqe nga të gjithë anëtarët e Njesisë së Prokurimit.

- Data zhvillimit të procedurës së prokurimit elektronik është 14 .02 2025 **ora: 10:00** ,
vendi: në mënyrë elektronike WWW.app.gov.al.

Në përfundim u vendos vazhdimi i mëtejshëm i procedurave ligjore të prokurimit.

NJËSIA E PROKURIMIT